



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



Lënda: Fonetikë dhe Fonologji italiane
Titullari /pedagogu i lëndës: Prof. Dr. Klodeta Dibra
Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore
Tipologjia e lëndës: B
Viti akademik: 2023 – 2024 semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: “Bachelor” në Gjuhë Italiane
Kodi i lëndës: Kodi i Etikës UT (nenet 4,6,7,9)
Adresa elektronike: klodetadibra@unitir.edu.al

OBJEKTIVAT E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Fonetikë dhe Fonologji italiane është lëndë e detyrueshme dhe lëndë e formimit gjuhësor. Ajo e formon studentin me nocionet mbi Fonetikën dhe Fonologjinë, si edhe e aftëson në të folurin korrekt të gjuhës.

Objektivat e përgjithshme lëndore

Studenti duhet të jetë i aftë të:

- njohë konceptet që lidhen me Fonetikën dhe Fonologjinë italiane, në përqsasje edhe me gjuhën shqipe;
- kryejë në klasë dhe jashtë saj ushtrime të ndryshme në mënyrë individuale apo në grup;
- ndërveprojë në mënyrë të pavarur

Objektivat specifike lëndore

Studenti duhet të jetë i aftë të:

- asimilojë konceptet kryesore që lidhen me Fonetikën dhe Fonologjinë italiane.
- transkriptojë zanore, bashkëtingëllore, fjalë të plota apo edhe fjali, duke respektuar rregullat ndërkombëtare të transkriptimit.
- dallojë tiparet e përbashkëta dhe dallimet midis dy sistemeve gjuhëre, italiane dhe shqipe, në rrafshin e dukurive fonetike dhe fonologjike.
të përftojë njohuri mbi theksin, ritmin, intonacionin, dinamizmin ligjërimor, strukturimin e ligjërimin gojor.

Rezultatet e të nxënit:

- Zhvillimi i aftësive të folurit
- Zhvillimi i ligjërimit gojor, sipas elementëve prozodikë të gjuhës italiane
- Zhvillimi i aftësive ndërvepruese
- Zhvillimi i dialogut në klasë
- Zhvillimi i aftësive të dëgjimit
- Zhvillimi i pavarësisë në komunikimin me gojë
- Zhvillimi i debatit në auditor
- Zhvillimi i mendimit kritik